



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 14 qershor 2011
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS TË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Goran Marinković, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Rasim Demiri, anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Nga stafi këshillues i komisionit morën pjesë: Avni Arifi dhe Naim Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më 25.05.2011 dhe 02.06.2011
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim amendamenteve për Projektligjin për Mbrojtje nga Zjarri;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale
5. Detyrimet e Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011;
6. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më 25.05.2011 dhe 02.06.2011

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim amendamenteve për Projektligjin për Mbrojtje nga Zjarri

Kryetari i Komisionit- Sa i përketë kësaj pike ja jap fjalën kryesuesit të këtij grupit punues z. Fatmir Xhelili.

Fatmir Xhelili- Grupi punës ka shqyrtuar dhe ka amendamentuar këtë projektligj dhe janë disa amendamente sipërfaqësore dhe nuk janë përmbajtjesore që e prekin thelbin e këtij projektligji dhe të gjithë anëtarët e grupit punës kanë qene unanim ne votimin e këtyre amendamenteve prandaj propozoj që në ta miratojë dhe të procedojmë tutje.

Vjollca Krasniqi- Unë nuk i kam këto amendament- propozime dhe nuk e di sa çfarë janë propozuar me këto propozime por unë kam vërejtje sa i përketë këtij projektligji konkretisht nenit 11, 13 dhe 14, ku sipas këtyre neneve behet një centralizim i madhe i shërbimeve dhe marrje e kompetencave të komunave nga mistria. Po ashtu themelimi i agjencionit për menaxhimin e emergjencave është pa bazë ligjore. Po sa i përketë lejes për përdorimin e ndërtimit dhe përdorimit të objekteve jepet na ministra nuk është ne rregull dhe kjo kompetencë duhet të i lihet komunave- gjegjësisht organit kompetent komunal.

Fatmir Xhelili- Sistemi ynë i menaxhimit të emergjencave funksionon në tri nivele, në atë lokal, rajonal dhe në nivelet shtetëror. Sa i përketë themelimit të Agjencisë kjo është e nevojshme sepse ky agjencia do të menaxhojë në rast të paraqitjes së situatave emergjente në dy a më shumë komuna. Po ashtu ky projektligj është në pajtim edhe me ligjin për pushtet lokal. Përveç kësaj kemi dy dokumente strategjike Strategjia e integruar për menaxhimin e situatave emergjente dhe Planin e veprimit kombëtarë ku këto gjera janë të rregulluar. Prandaj kërkoj që Projektligji të shkojë në procedim të mëtutjeshëm.

Vjollca Krasniqi- Unë theksoi edhe njëherë se më këtë projektligj është kufizuar kompetenca e komunave. Plus kësaj edhe Departamenti i Buxhetit thekson se ka paqartësi rreth financimit të inspektoreve të agjencisë për mbrojtje nga zjarri dhe kjo është një fakt që tregon se disa gjera në këtë ligj janë të paqarta.

Fatmir Xhelili- Nuk ka të bëjë me marrje të kompetencave të komunave, vetëm do të këtë unifikim të shërbimeve të zjarrfikës, sepse inspektorët komunalë do të jenë prapë përgjegjës për zbatimin e ligjit.

Kryetari i Komisionit- Do të ishte mire që grupi i punës ta këtë edhe një takim që të harmonizohen qëndrimet.

Rexhep Selimi- i përcolla me vëmendja shqetësimet e deputetes Krasniqi dhe mendoj që janë të konsiderueshme dhe ska asgjë të keqe të kemi edhe një takim ku edhe deputetja të jete e pranishme dhe të trajtohen këto çështje.

Goran Marinkovic- Për korrektësinë ndaj deputetes Krasniqi ne si grup punës them të takohemi edhe një here.

Anton Quni- Është e pranueshme që shqetësimet që u ngritën këtu të adresohet. Kemi të bëjmë me çështje teknike e jo politike. Prandaj duhet ti tejkalohen barrierat e panevojshme.

Kryetari i Komisionit- e mbyllim diskutimin rreth kësaj pike dhe grupi punës e mban edhe një takim dhe prezantohen argumentet dhe procedojmë me tutje.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale

Kryetari i Komisionit- Sa i përketë kësaj teme unë ju njoftoi se kam pasur një takim edhe me Kryetarin e Kuvendit dhe jemi sqaruar sepse këta nuk janë shërbyes civilë, por emërohen me vendim të seancës plenare. Kjo listë është një formacion i propozuar nga Qeveria, dhe unë sot jam që në si Komision ti japin vizën për seance plenare.

Rexhep Selimi- Nëse kushtet ligjore janë të plotësuar atëherë në skemë personalisht me asnjë emër ndonjë kundërshtim dhe e përkrahim.

Fatmir Xhelili- e përkrahim listën dhe jemi dakord që kjo të procedohet në Kuvend.

Kryetari i Komisionit- e hedh në votim pra këtë listë me këtë emër. A ka dikush kundër. Jo. Abstenim nuk ka dhe konstatoi se komisioni, miraton propozimin për emërimin e anëtarëve të agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ja procedojmë në mbledhjen plenare për më tej.

5. Detyrimet e Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011

Kryetari i Komisionit- në si komision kemi pas një plan veprim për këtë çështje dhe ka qenë i caktuar z. Xhelili si përgjegjës i komisionit dhe kisha shtu që ky plan të azhurnohet dhe vijohet puna me intensitet më të shtuar.

Fatmir Xhelili- propozoi që në kauder të këtyre obligimeve që dalin nga Raporti i Progresit në të marrim ligjin për të huajt për të mbikëqyrur zbatimin e tij.

Kryetari i Komisionit- A pajtoheni që komisioni të mbikëqyrë procesin e zbatimit të ligjit për të huajt. Pra konstatoi që komisioni merr vendim të behet zbatimi i projkligjit për të huajt.

6. Të ndryshme

Nuk pati diskutime lidhur me këtë pikë.

Mbledhja përfundoj në ora: 11:00.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi